

# **RAPORT**

## **I VLERËSIMIT TË JASHTËM, PËR PROGRAMIN E STUDIMIT JOUNIVERSITAR, PROFESIONAL PAS ARSIMIT TË MESËM, ME KOHË TË PLOTË NË “TEKNOLOGJI AUTOMJETESH” NË KOLEGJIN PROFESIONAL TË TIRANËS**

Eksperti i vlerësimit të jashtëm: Dr. Gazment Qatipi



Korrik/2017

## **RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **Për Programin e Studimit profesional dy vjeçar në Teknologji Automjetesh**

<b>Tabela e të dhënave për programin e studimit</b>		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Profesional i Tiranës
2	Departamenti që e ofron	Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara
3	Urdhëri/VKM i licencimit Urdhëri i riorganizimit	Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 699, datë 26.08.2015 Leja e fillimit të aktivitetit: Urdhër Nr. 426, datë 06.11.2015
4	Titulli i programit të studimit:	Program Studimi jouniversitar, profesional, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë, në Teknologji Automjetesh (*)
5	Cikli i studimit:	N/A Program studimi me karakter profesional
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
7	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	PO
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	5
15	Aktivizimi i programit të studimit	2015-2016
16	Numri total i studentëve për program studimi	81

**\*) Emërtimi i programit të studimit sipas VKM është:** Program Studimi jouniversitar, profesional, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë në Teknologji Automjetesh

Ligji i Arsimit të lartë nr 80/2015 në nenin 72, pika 1 shkruan: IAL mund të ofrojnë programe studimi me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, [...] dhe në përfundim lëshohet respektivisht "Certifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimit të kryer

#### **Shënim:**

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

## HYRJE

Ky raport bazohet në Dokumentacionin e sjellë nga Kolegji Profesional i Tiranës (KPT), ku përfshihet edhe një Raport i vlerësimit të Brendshëm, si dhe në vizitën dy ditore të zhvilluar në këtë institucion nga Grupi i vlerësimit të jashtëm, më 20 dhe 21 Korrik 2017.

Të gjitha takimet u zhvilluan, sipas axhendës së hartuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

### Datë 20.07.2017

Ora	Veprimtaria e Planifikuar
08.00 – 08.30	Takim i grupit për të diskutuar mbi vizitën
08.30 – 09.00	Takim me Titullarin e Institucionit (për 4 programet e studimit)
09.00 – 10.00	Takim me Përgjegjësën e Departamentit (për 4 programet e studimit)
10.00 – 10.30	Takim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe zyrën e karrierës (për 4 programet e studimit)
10.30 – 11.30	Takim me Grupet e vetëvlerësimit për programet: <ul style="list-style-type: none"><li>• Diplome 2 Vjeçare Profesionale "Elektro Mekanikë"</li><li>• Diplome 2 Vjeçare Profesionale Teknologji Automjetesh</li><li>• Diplome 2 Vjeçare Profesionale Elektronikë</li></ul>
11.30 – 12.30	Takim me stafin akademik (të brendshëm dhe të jashtëm), për programet: <ul style="list-style-type: none"><li>• Diplome 2 Vjeçare Profesionale "Elektro Mekanikë"</li><li>• Diplome 2 Vjeçare Profesionale Elektronikë</li></ul>
12.30 – 13.30	Takim dhe intervista me studentët, për programet: <ul style="list-style-type: none"><li>• Diplome 2 Vjeçare Profesionale "Elektro Mekanikë"</li><li>• Diplome 2 Vjeçare Profesionale Elektronikë</li></ul>
13.30 – 14.00	Diskutim i GVJ për Takimet e kryera
14.00 – 15.30	Takime dhe vizita në sekretarinë mësimore, në zyrën e burimeve njerëzore dhe zyrën e kurrikulave, për programet: <ul style="list-style-type: none"><li>• Diplome 2 Vjeçare Profesionale "Elektro Mekanikë"</li><li>• Diplome 2 Vjeçare Profesionale Elektronikë</li></ul>
15.30 – 16.15	Vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.), vizitë në Bibliotekë, për programet: <ul style="list-style-type: none"><li>• Diplome 2 Vjeçare Profesionale "Elektro Mekanikë"</li><li>• Diplome 2 Vjeçare Profesionale Elektronikë</li></ul>
16.15 – 16.45	Takimi përfundimtar me Titullarin e institucionit

### Datë 21.07.2017

Ora	Veprimtaria e Planifikuar
08.00 – 08.30	Takim i shkurtër i Grupit (Diskutime për pikat kryesore të agjendës)
08.30 – 09.30	Takim me Grupin e vetëvlerësimit për programin: <ul style="list-style-type: none"><li>• Diplome 2 Vjeçare Profesionale Teknologji Ajrimi dhe kondicionimi</li></ul>
09.30 – 10.30	Takim me stafin akademik (të brendshëm dhe të jashtëm), për të dy programet
10.30 – 11.30	Takim dhe intervista me studentët, për të dy programet
11.30 – 12.30	Takime dhe vizita në sekretarinë mësimore, në zyrën e burimeve njerëzore dhe zyrën e kurrikulave, për të dy programet
12.30 – 13.00	Diskutim i GVJ për Takimet e kryera
13.00 – 14.00	Vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.) Vizitë në Bibliotekë, për të dy programet
14.00 – 14.15	Takimi përfundimtar me Titullarin e institucionit, për të dy programet



Programi i Studimit jouniversitar, profesional, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë, në **Teknologji automjetesh** është licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 699, datë 26.08.2015 "Për licencimin e institucionit të Arsimit të Lartë, privat, me statusin e Kolegjit Profesional "Kolegji Profesional i Tiranës", Tiranë". KPT është pajisur me lejen e fillimit të aktivitetit me Urdher Nr. 426, datë 06.11.2015 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike, në përputhje me licencën e dhënë institucionit të arsimit të lartë privat Kolegji Profesional i Tiranës, Tiranë"

Ky program ka filluar aktivitetin dhe ka regjistruar studentë në vitin akademik 2015-2016 dhe në dy vite ka regjistruar përkatësisht 84 studentë. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara.

## **GRUPI I VLERSIMIT TE JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ:

### 1. Dr. Gazment Qatipi

Nga ASCAL mori pjesë specialistja Znj. Majlinda Demirneli.

Kolegji Profesional i Tiranës" me shkresë Nr. 263 Prot, datë 17.08.2017 "Mbi Draft - Raportin e Vlerësimit të jashtëm për programin e studimit profesional dy vjeçar në "Teknologji Automjetesh" në Kolegjin Profesional të Tiranës"" ka dërguar komente në lidhje me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për Programin e studimit profesional dy vjeçar në "Teknologji automjetesh". Eksperti pasi njohu komentet e institucionit, në lidhje me Draft Raportin, reflektoi ndryshime në Raportin përfundimtar.

## **1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit, mësimdhënia, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për programin e studimit (historiku, numri i punonjësve në vite, numri i studentëve në vite, vendi i Programit të studimit në kuadrin e kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Referuar Raportit të vlerësimit të brendshëm, misioni i programit të studimit profesional dy vjeçar në Teknologji Automjetesh është "të pajisë studentin me njohuri të thella tekniko – aplikative të nivelit profesional dhe praktik, që kërkohen nga fusha të ndryshme të të ndërtimit dhe shërbimit të automjeteve si dhe me aftësi për të hyrë menjëherë në tregun e punës së industrisë së servisit të automjeteve. Gjithashtu ky program studimi synon të pajisë studentët me njohuri të plota mbi shërbimet, riparimet dhe ndërtimin e automjeteve, si dhe eksperiencë profesionale në laboratorët / ofcinat e shkollës, e nevojshme për të pasur sukses në punë"

Mendojmë se konceptimi i misionit të këtij programi studimi është i drejtë dhe i arritshëm nga studentët. Garanci për këtë janë objektivat e lëndëve përbërëse të këtij programi, si dhe mbështetja e zhvillimit të tyre me bazë të mjaftueshme laboratorike dhe ofcinat për shërbimin e automjeteve.

Besueshmërinë e arritjes së këtij misioni e garanton cilësia e stafit akademik që angazhohet në realizimin në praktikë të këtij programi.

## Vlerësimi sipas standardeve

### **Standardi 1: Aftësitë specifike të lidhura me sektorin e punësimit janë zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar gjatë gjithë zhvillimit të programit të studimit**

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

- Kriteri 1** Punësimi është trajtuar në hartimin e kurrikulave, në karrierën arsimimin, informimin dhe udhëzimet.
- Kriteri 2** Punësimi është një çështje kyçe për miratimin e programit, monitorimin dhe rishikimin e tij.
- Kriteri 3** Studentëve i është dhënë mbështetje për zhvillimin e aftësive në funksion të punësimit.
- Kriteri 4** Programi parashikon dhe kredite të përfituara gjatë punës
- Kriteri 5** Të përfshijnë inisiativa specifike si psh. mbështetje për sipërmarrjen
- Kriteri 6** Krijimi i lidhjeve punëdhënës / IAL.

#### **Vlerësimi sipas standardit 1:**

Vlerësojmë se kërkesat e standardit (kriteret) kanë qenë në qendër të vëmendjes së KPT, pasi i gjithë institucioni në Misionin e tij ka në qendër cilësinë e edukimit profesional dhe punësimin e studentëve si objektiv final, duke qenë ndër të parët institucione në Shqipëri. Hartimi i Strategjisë së zhvillimit të institucionit për vitet 2015-2020 në të cilën institucioni *'është pozicionuar si urë lidhëse midis edukimit akademik dhe trainimit profesional, duke i ndihmuar studentët në integrimin sa më të lehtë në tregun e punës'* (RVB fq 4), mendojmë se ndihmon edhe në politikat e ndjekura të edukimit dhe më vonë punësimit për këtë program studimi.

Mendojmë se procesi i hartimit dhe përmirësimit të kurrikulave lëndore, mbështetja e tyre me aktivitete laboratorike dhe praktika profesionale, si dhe bashkëpunimi me tregun rajonal të punës ka sjellë arritjen e objektivave të programit.

Koha e shkurtër e aktivitetit të këtij institucioni dhe programit PS-TA tregon njëherazi punën e strukturave akademike për të arritur maksimumin e objektivave, por edhe punën e mëtejshme që ka filluar dhe duhet të vazhdojë për përmirësimin e kurrikulës, sipas kërkesave të tregut të punës, gjë që u evidentua edhe në takimet me drejtuesit dhe stafin akademik.

Hartimi i kurrikulës bazuar në procesin e Bolonjës, ligjin e Arsimit të lartë Nr. 80/2015, si dhe në standardet e cilësisë është një garanci më tepër për cilësinë e përgatitjes së studentëve dhe që lejon transferimin e tyre. Institucioni ka një politikë të qartë për punësimin e studentëve dhe për këtë është angazhuar, si në njohjen e studentëve me bizneset rajonale/kombëtare në fushën e teknologjisë së automobilave (servise, kompanitë koncesionare etj) ashtu edhe në punësimin e studentëve të sapo diplomuar në kompani apo biznese me të cilat janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Për këtë shërben zyra e informacionit dhe e mbështetjes së studentëve e cila në veprimtarinë e saj të përshkruar në Statutin e Institucionit ka orientimin e karrierës dhe punësimin e studentëve (Statuti fq 7).

#### **Konkluzionet e GVJ:**

- Konceptimi i Misionit dhe objektivave të këtij programi studimi është i drejtë dhe i arritshëm nga studentët. Garanci për këtë janë:
  - o objektivat e lëndëve dhe mbështetja e zhvillimit të tyre me bazë laboratorike dhe aftësim praktik brenda institucionit dhe jashtë tij.
  - o cilësia e stafit akademik që angazhohet në realizimin e këtij programi.
- Misioni i institucionit ka harmoni dhe përputhet me Misionin e programit të studimit që ka në qendër cilësinë e edukimit profesional dhe punësimin e studentëve si objektiv final.
- Institucioni ka një politikë të punësimit të studentëve. Për këtë shërben edhe Zyra e informacionit dhe e mbështetjes së studentëve, e cila në veprimtarinë e saj të përshkruar në Statutin e Institucionit ka orientimin e karrierës dhe punësimin e studentëve (Statuti fq 7).



## 2. Struktura akademike e Njesisë Bazë - Departamenti i Elektro Mekanikës dhe sistemeve të Aplikuara

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për personelin akademik në njësinë bazë, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ, koordinimi i mësimdhënies me njësi të tjera të institucionit.

Në Raportin e vlerësimit të brendshëm prezantohet se në dhjetor 2016 dy Departamente të KPT janë bashkuar në një departament të vetëm. Me vendim të Senatit akademik Nr. 22 Prot., datë 05.12.2016 u riorganizuan *Departamenti i Elektro Mekanikës* dhe *Departamenti i Ndërtimit dhe Sistemeve të aplikuara* në **Departamentin e Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara** (RVB fq 7). Ky departament është përgjegjës për programin e studimit profesional 2 vjecar në **Teknologji Automjetesh**. Kjo strukturë është përgjegjëse edhe për 5 programe studimi profesionale dy vjecare:

- Elektro Mekanikë
- Mekatronikë
- Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi
- Gjeodezi
- Teknologji Ndërtimi

Struktura akademike përfshin Përgjegjësin e Departamentit (me titull Prof Dr) dhe stafin akademik. Mendojmë që kjo strukturë akademike është në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë nr. 80/2015.

Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti drejtues i Departamentit. Ai përzgjidhet dhe emërohet nga Rektori me mandat 4 vjecar, me të drejtë rizgjedhje. Përgjegjësi i Departamentit, sipas Statutit ka këto kompetenca:

- a) Organizon, koordinon dhe drejton aktivitetin mësimor dhe akademik të departamentit
- b) Shqyrton dhe miraton planet mësimore dhe programet e studimit, si dhe ndryshimet e programeve të studimit;
- c) Përgatit rregulloren për programet e studimit dhe ia dergon për miratim Senatit akademik;
- d) Shqyrton dhe jep mendim për tekstet mësimore që do të përdoren;
- e) Ndjek realizimin e programit mësimor sipas planit të miratuar dhe mbikqyr cilësinë e mësimdhënies;
- f) Miraton dhe firmos tezat e provimeve;
- g) Merr pjesë në komisionet e përzgjedhjes së pedagogëve të rinj;
- h) Bën vlerësimin e pedagogëve të departamentit gjatë vitit;
- i) Ngre dhe miraton komisionet e përzgjedhjes së studentëve të rinj;
- j) Drejton komisionet e transferimit të studentëve, të ndërprerjes dhe rifillimit të studimeve
- k) Etj.

Personeli Akademik i Departamentit përbëhet nga Personel Akademik Efektiv (PAE), Personel Akademik me Kontratë (PAK), personeli ndihmës shkencor dhe Personeli Administrativ (PA).

Sipas Statutit, personeli akademik përzgjidhet me konkurs dhe nga një komision rekrutimi dhe sipas klasifikimit:

- personeli akademik kryen veprimtari mësimdhënëse, kërkim shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin e institucionit, këshillim për studentët (tutoriat), etj. Ai duhet të ketë të paktën Diplomë Master Profesional.
- Personeli ndihmës mësimor kryen veprimtari ndihmëse në mësimdhënie, laboratore, shërbime etj
- Personeli Administrativ kryen veprimtari administrative në ndihmë të procesit mësimor

### Tregues të matshëm:

- Struktura didaktike e Departamentit për programin e studimit

Pjesë e strukturës së departamentit janë 7 laboratorë dhe tre oficina. Në funksion të Programit të studimit TA janë:

1. Laboratori i Fizikës
2. Laboratori i Mekanikës dhe shkencave materiale
3. Laboratori i Pneumatikës dhe Elektropneumatikës dhe PCL (Programmable Logic Controller)
4. Laboratori i Autotronikës
5. Laboratori i Makinave elektrike
6. Oficina e automjeteve dhe Mekanikës
7. Oficina e Makinave elektrike

Në funksion të programeve të tjera të studimit, që Departamenti ofron janë edhe:

1. Laboratori i Gjeodezisë
2. Laboratori i HVAC (Heating Ventilation Air Condition) dhe Termoteknikës
3. Oficina e HVAC

Për pajisjen e laboratorëve, institucioni ka nënshkruar marrëveshje me Kompaninë 'SPA Polytech' Greqi, e cila ka marrë përsipër pajisjen, mirëmbajtjen dhe rinovimin e laboratorëve, si dhe trainimin e specialistëve të KPT. Kjo strukturë mbështetëse laboratorike dhe ofcinat shërbejnë për zhvillimin e lëndëve të programit të studimit brënda parametrave dhe kërkesave të syllabuseve.

- Numri i personelit akademik në Departament: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA), titujt/gradat, (Tabela 1, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 1

Viti akademik	Stafi akademik i Departamentit				Total
	Numri i PAE	Numri i PAK	Numri i Stafit të ftuar	Numri i Stafit Administrativ**	
2015 - 2016	16	3	-	4	19
2016 – 2017*	11	15	-	14	26

\*) Të dhënat për këtë vit akademik përfshijnë shkrirjen e dy departamenteve dhe krijimin e një departamenti të vetëm

\*\*\*) Numri i stafit administrativ jepet për të gjithë institucionin, prandaj në kolonën Totali jepet vetëm totali i PAE dhe PAK.

Në Tabelën 2 jepet stafi akademik PAE dhe PAK në departamentin e Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara

Tabela 2



Stafi akademik Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara							
	PAE (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli /Grada		PAK (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Marenglen Gjonaj	P. Dep	Prof Dr	1	Miranda Kullolli	Prof.As	UPT
2	Antoneta Deda	Pedagog	Prof.Dr	2	Elfrida Topçiu	Dr.	Pension
3	Arben Dushi	Pedagog	Prof.As	3	Idajet Selmani	Msc	Shkolla e mesme Zall Bastar
4	Piro Dhimitri	Pedagog	Msc	4	Luisa Dhimitri	Msc	-
5	Konti Tafa	Pedagog	Msc	5	Angjelin Shtjefni	Prof.As	pension
6	Ilir Palushaj	Pedagog	Msc	6	Majlinda Alcani	Prof.As	UPT
7	Teuta Halilaj	Pedagog	Msc	7	Fatmir Basholli	Dr	Albanian University
8	Marjeta Dhima	Pedagog	Msc	8	Elvis Idërsha	Msc	
9	Artur Ruzi	Pedagog	Msc	9	Gëzim Minga	Msc	MPB
10	Vladimir Sinani	Pedagog	Msc	10	Sashenka Avrami	Msc	ERT
11	Leon Merja	Pedagog	Msc	11	Preni Muça	Msc	Shkolla Harry Fultz, Tiranë
				12	Bledar Bregu	Msc	EPPC Albania
				13	Novruz Poda	Msc	Albagaz
				14	Fejzo Nikollari	Msc	Sanuzi Selfa
				15	Migena Zeqo	Msc	UPT

Departamenti plotëson kërkesat për numrin e përgjithshëm të stafit dhe numrin e stafit me tituj /grada.

### 3. Personeli akademik dhe ai mbështetës për Programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Në Raportin e vlerësimit të brendshëm dhe gjatë vizitës në institucion grupi i vlerësimit të jashtëm u njoh me kujdesin që ka institucioni për të angazhuar staf sa më të kualifikuar dhe me eksperiencë të gjatë në fushën e teknologjisë mekanike, teknologjisë së automjeteve dhe të inxhinierisë në përgjithësi. Personeli akademik i programit në pjesën më të madhe vjen nga departamenti përgjegjës, por për plotësimin e kurrikulës janë angazhuar edhe nga Departamenti i Teknologjisë së informacionit apo të tjerë. Drejtuesit e institucionit dhe Departamentit kanë gërshetuar personelin e kualifikuar dhe atë me eksperiencë në lëndët e formimit profesional.

Procedura e punësimit jepet në Manualin e Burimeve Njerëzore. Në këtë manual jepen:

- Politikat dhe procedurat e burimeve njerëzore;
- Kriteret e vlerësimit/rekrutimit.
- Përcaktimi i nevojave për personel të ri. Aty përcaktohet se është departamenti që bën analizë të kapaciteteve dhe kur ka nevojë për personel të ri ai ja paraqet kërkesën rektorit.
- Përzgjedhja e kandidatëve. KPT pranon aplikime gjatë gjithë vitit. Aplikimi mund të bëhet edhe në [www.KolegjiProfesional.edu.al](http://www.KolegjiProfesional.edu.al). Përzgjedhja e parë bëhet nga Zyra e Burimeve njerëzore.
- Zhvillimi i intervistës nga Komisionet e rekrutimit.
- Paraqitja e një leksioni të hapur në Departament



- Hartimi i Kontratës
- Politikat për ruajtjen e informacionit personal, standardet e sjelljes në punë etj.
- Vlerësimi i pedagogut (nga eprori, nga studentët). Ky vlerësim organizohet nga Zyra e NjSBC Ngarkesa e stafit akademik përcaktohet nga departamenti dhe përfshihet në kontratën individuale.

**Tregues të matshëm:**

- Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për programin e studimit (Tabelat 3, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Në Tabelën 3 janë dhënë të ndarë stafi akademik efektiv dhe me kontratë **për programin e studimit TA**

Tabela 3.1

Stafi akademik I programit të studimit Teknologji Automjetesh (***)						
	PAE (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada		PAK (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Shpëtim Bozo	Prof .Dr	1	Elfrida Topçiu	Dr	pension
2	Antoneta Deda	Prof. Dr	2	Idajet Selmani	Msc	Shkolla e mesme Zall Bastar
3	Teuta Halilaj	Msc	3	Miranda Kullolli	Prof.As	UPT
4	Ervin Suli	Msc	4	Gëzim Minga	Msc	MPB
5	Pirro Cipo	Prof. Dr	5	Migena Zeqo	Msc	UPT
6	Dritan Karriqi	Msc	6	Elvis Idërsha	Msc	
7	Thimi Oço	Msc	7	Fejzo Nikollari	Msc	
8	Besnik Sadaj	Msc				
9	Engjëll Ciraku	Msc				
10	Leon Merja	Msc				
11	Marenglen Gjonaj	Prof. Dr				
12	Petro Plasa	MND				
13	Ilir Palushaj	Msc				
14	Konti Tafa	Msc				
15	Arben Dushi	Prof. As				
16	Marjeta Dhima	Msc				
17	Artur Ruzi	Msc				
18	Piro Dhimitri	Msc				

\*\*\*) të dhënat janë nxjerrë nga Tabela 10 e RVB

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 3.2, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 3.2

Titulli	Programi i studimit Teknologji Automjetesh		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	4		4/0
Profesorë të As.	1	1	1/1
Doktorë		1	0/1
MND	1		1/0
Msc	12	5	12/5
	18	7	18/7

Sic del nga të dhënat, raporti PAE dhe PAK në programin e studimit është **18/7** ose 72 %/ 28 %. Pra plotësohet kushti që të paktën 70 % e programit të mbulohet nga Stafit akademik efektiv. Në fakt ky raport është edhe më i lartë nëse shohim ngarkesën në orë mësimore (shih Kapitullin 7 Programi i studimit)

**Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat.**

Në Dosjen e vetëvlerësimit janë modelet e kontratave individuale për stafin akademik të punësuar me kohë të plotë dhe atë të punësuar part time. Kontratat kanë të drejtat dhe detyrat e stafit akademik, ngarkesën në orë mësimore, etj. Në zyrën e burimeve njerëzore GVJ u njoh me dy Dosje të zgjedhur në mënyrë rastësore (të dy pedagogëve). Në këto dosje u gjetën të gjitha dokumentat që kërkon rregullorja:

- Kontrata e nënshkruar nga punëdhënësi dhe pedagogu
- Diplomë e arsimit të Lartë, lista e notave shoqëruar me dokumentacionin që tregon kualifikimin, gradat, titujt, specializimet, trainimet etj
- CV e pedagogut, (Format i BE)
- Vërtetim page dhe Leja e drejtuesit , kur pedagogu është part time
- Libreza e punës dhe librezë kontributesh (Sig shoqëror dhe Sig. Shëndetësor)
- Raport i aftësisë për punë/librezë shëndetësore
- Etj

Kontratat për stafin akademik të ri zgjasin një semestër (që quhet edhe periudhë prove). Kontrata vazhduese për stafin akademik të brëndshëm është vjetore dhe më tej ajo është pa afat.

**Ngarkesa semestrale, vjetore etj**

Në RVB dhe në takimet me stafin akademik GVJ u informua për ngarkesën mësimore, e cila përcaktohej nga Përgjegjësi i departamentit, bazuar në Statutin dhe rregulloren e institucionit dhe që pasqyrohet në kontratën e punës. Në rregulloren e institucionit (Neni15). Kriteret për shpërndarjen e ngarkesës mësimore të personelit akademik rregullohen me dokument të veçantë.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

**Standardi 2 Aftësi të transferueshme janë zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar gjatë gjithë programit**

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

**Kriteri 1** Punëdhënësit ndihmojnë në përcaktimin e përvojave thelbësore (p.sh. përvoja e punës) dhe aftësitë ndër-kurrikulare, qëndrimet dhe njohuritë (p.sh. të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, komunikimi, TIK, marrëdhëniet me klientët)

**Kriteri 2** Çdo aftësi është ndjekur përmes moduleve (Përmbajtja e kursit, metodat e mësimdhënies, vlerësimit) në fazat e zhvillimit të kurrikulës dhe nëpërmjet rishikimit të programit.

**Kriteri 3** Rezultatet janë të monitoruara (p.sh. punësimi i të diplomuarve).

**Vlerësimi sipas standardit 2:**

KPT është një institucion i mirëorganizuar në funksion të parapërgatitjes së vitit akademik, mirëpritjen dhe orientimin e studentëve gjatë fillimit të tyre me kurrikulën, përmbajtjen e syllabuseve, zhvillimin e vitit akademik dhe vlerësimin e studentëve për njohuritë e tyre teorike dhe aftësitë praktike.

Të gjithë pedagogët kanë ndjekur me korrektësi syllabuset e aprovuara paraprakisht nga Departamenti. Kjo do të thotë që janë zhvilluar modulet lëndore në tërësinë e formave të mësimdhënies (leksione, seminare, praktika lëndore, laboratorë etj). Stafit akademik është i angazhuar si për harmonizimin e këtyre



elementëve ashtu edhe për përmirësimin e kurrikulës në drejtim të përditësimit me teknologjitë e reja në fushën e teknologjisë së automjeteve. Ndryshimi i disa lëndëve (brënda 20% të lejueshëm) e tregon këtë. Eksperienca profesionale e deritanishme për studentët në këtë program studimi është e lavdërueshme.

Gjithashtu ndjekja e arritjeve të studentëve gjatë vitit akademik, nëpërmjet tutorëve mendojmë se rrit përgjegjësitë e dyanshme, si të studentëve të cilët bëhen më të përgjegjshëm dhe synojnë të kërkojnë më tepër, ashtu edhe stafit akademik që është vazhdimisht pranë tyre, për t'i ndihmuar.

Shkalla e punësimit mbetet për t'u vlerësura pas përfundimit të këtij viti akademik, por drejtuesit e KPT janë optimistë, duke patur parasysh:

- Njohjen e ndërsjellë të studentëve me tregun e punës dhe kompanitë ku bëhen praktikat profesionale me cilësinë e tyre;
- Veprimtaria e zyrës së informacionit dhe mbështetjes së studentëve, e cila në detyrat e saj ka edhe ndihmën për punësim;
- Vetëpunësimi, si pjesë e të gjithë politikave të arsimit dhe formimit profesional

*Rekomandim:* Rritja e orëve (krediteve) për praktikën profesionale është shumë e vlefshme. Megjithatë mendojmë se ka vënd përsëri për shtimin e krediteve në këtë lëndë. Kjo do ti aftësojë më shumë studentët në drejtim të shkathtësive dhe shprehive të nevojshme në procese të shumëllojshme që ka kjo fushë shërbimesh.

#### **Standardi 5: Stafit zotëron aftësi, sjellje dhe përvojë të duhur për rezultatet e pritshme të programit**

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

**Kriteri 1** Të dhëna nga specialistë të sektorit përkatës të punësimit

**Kriteri 2** Stafit mësimdhënës angazhohet në përditësimin e mëtejshëm, specifikisht për anën profesionale, lëndët dhe vendet e punës

**Kriteri 3** Janë ngritur sisteme për evidentimin e hershëm dhe ofrimin e mbështetjes, për mbështetjen e të mësuarit tek studentët

**Kriteri 4** Stafit ka siguruar mbështetje për studentët me kohë të pjesshme (part time), p.sh. nëpërmjet email-it, ofrimin të të mësuarit virtual dhe ambienteve përkatëse (e-learning).

#### **Vlerësimi sipas standardit 5:**

Duke njohur CV e stafit dhe duke takuar një pjesë të tyre gjatë vizitës në KPT rezultojnë se një pjesë e stafit akademik është me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie në Universitetin Publik, apo në arsimin profesional, një pjesë tjetër është staf i ri, ndërsa një pjesë janë pjesë e kompanive, në të cilat studentët bëjnë praktikat profesionale. Kjo strukturë mendojmë se ka sjellë aftësi dhe përvojën e duhur për të realizuar programin e studimit brënda parametrave të Standardit 5.

Stafit akademik duke analizuar syllabuset e lëndëve, objektivat lëndore ka gjetur 'pikat' që duhen zgjidhur dhe përmirësuar. Mendojmë se kështu ai ka treguar aftësi dhe sjellje profesionale, për të përmirësuar rezultatet e pritshme të programit të studimit.

Studentët kanë gjetur ambient pune dhe angazhim të stafit, në mbështetjen e studentëve në procesin e të nxënies. Laboratorët dhe ofcinat janë ambiente ku studentët mund të kalojnë më shumë kohë, duke rritur pasionin për profesionin.

Një mbështetje për studentët janë edhe **Platforma online Sharefolder** (intranet) dhe sistemi i menaxhimit **Classter** (ofruar nga Tech360 shpk). Këto platforma japin informacion për: oraret e mësimin, sezonet e provimeve, rezultatet e vlerësimit, si dhe materiale që lidhen me programin e studimeve (leksionet në formë dixhitale, materiale të tjera studimore), duke lehtësuar marrjen e leksioneve dhe materialeve të tjera mësimorë në kohë reale. Gjithashtu faqja online e KPT ndihmon në dhënie të informacioneve të tjera me interes të përgjithshëm (lajmërimi, informacione sociale etj).

#### **Konkluzionet e GVJ:**

KPT është një institucion që punon në drejtim të parapërgatitjes së vitit akademik, mirëpritjen dhe orientimin e studentëve, informimit me kurrikulën dhe syllabuset, zhvillimin e vitit akademik dhe vlerësimin e studentëve për njohuritë e tyre teorike dhe aftësitë praktike.

Stafi akademik është i angazhuar si për harmonizimin e elementëve të mësimdhënies si leksione, seminare, praktika lëndore, laboratorë etj, ashtu edhe për përmirësimin e kurrikulës në drejtim të përditësimit me teknologjitë e reja në fushën e teknologjisë së automjeteve.

Struktura e stafit akademik ku gërshetohet eksperiencia e gjatë me stafin e ri dhe atë që vjen nga tregu i punës, mendojmë se ka sjellë aftësi dhe përvojën e duhur për të realizuar programin e studimit brënda parametrave të Standardit 5.

Studentët kanë gjetur mbështetje në procesin e të nxënit; laboratorët, ofcinat dhe platformat dixhitale kanë lehtësuar procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

*Rekomandim:* Rritja e orëve (krediteve) për praktikën profesionale është shumë e vlefshme. Megjithatë mendojmë se ka vënd përsëri për shtimin e krediteve në këtë lëndë. Kjo do ti aftësojë më shumë studentët në drejtim të shkathtësive dhe shprehive të nevojshme në procese të shumëllojshme që ka kjo fushë shërbimesh.

#### **4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Në RVB jepet një informacion i plotë për infrastrukturën e Kolegjit profesional të Tiranës. Të dhënat janë totale sepse të gjitha ambientet janë në dispozicion të të gjithë programeve të studimit.

KPT ka marrë një ambient me qera në Kompleksin 'Xhura', një pjesë të Godinës 2, me sip 2500 m<sup>2</sup> (dy kate të ndërtesës dhe ambiente ndihmëse). Në Godinën 1C janë marrë me qera 280 m<sup>2</sup>, që përdoret për laboratorë dhe ofcina. Ambienti përreth ka oborre, sipërfaqe parkimi, kafene etj.

Ambientet e brëndshme përmbushin normativat shtetërore të lartësisë së kateve, ndricimit dhe boxeve sanitare. Ndërtesa është e pajisur edhe me shkallë emergjence dhe dalje emergjence. Ambientet kanë mbrojtësit kundra zjarrit. Ndërtesa ka ngrohje qëndrore.

Më hollësisht të dhënat për infrastrukturën jepen në Tabelën 4

Nga Drejtuesit u deklarua se në shtator 2017 do merren edhe dy katet e tjera të ndërtesës me qera duke e çuar sipërfaqen totale në 12000 m<sup>2</sup>. Drejtuesit e shkollës kanë objektiv maksimal të kapaciteteve deri në 2400 studentë, në të gjithë programet e studimit që ofrojnë.



**Tregues të matshëm:**

- Mjediset e institucionit në funksion të programit të studimit** (Tabela 4, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Mjediset për Kolegjin (për programin e studimit)	Sasia	Sipërfaqja në m <sup>2</sup>
Salla për leksione	4	422
Klasa për seminare/ushtrime	5	224.5
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	4	283
Laboratorë për lëndët	5	288
Laboratorë informatike	2	112
Salla interneti	1	69
Salla për bibliotekë	1	90
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	27
Zyrë informacioni për studentët	1	18.5
Korridore/holle		442
Nyje hidrosanitare për studentët	5	109
Ambient teknik	1	14
Shkallë		122
<b>Norma m<sup>2</sup>/për student</b>		<b>6.49 m<sup>2</sup>/student</b>

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja në m <sup>2</sup>
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore		
Zyra për personelin akademik	6	155
Zyrë për financën	1	10
Zyrë për Njësinë e SBC	1	18.5
Salla për mbledhje		
Mjedis për stafin e shërbimit	3	73
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	1	22
<b>Norma m<sup>2</sup>/për person</b>		<b>8.46 m<sup>2</sup>/për person</b>

**Konkluzionet e GVJ:**

KPT ka infrastrukturë në funksion të programeve të studimit.

*Rekomandim:* të shihet mundësia që laboratorët dhe ofcinat të vihen në shërbim të të tretëve, duke krijuar të ardhura për shkollën, por dhe duke e afruar studentin më shumë në kushtet reale të tregut të punës në ofcinat e shkollës.

Të shihet mundësia që në ambjentet e laboratoreve, ofcinave te kete pankarta, informacione pamore, te dedikuara këto sipas tematikave të laboratoreve. Gjithashtu gjatë orëve laboratorike të kete video mbi veprimtrinë praktike, që zhvillohet në keto laboratorë. Këtë rekomandim e japim ne perputhje me nivelin e studentit, i cili eshte me prirje më të madhe drejt informacionit pamor, se sa të shkruar (mesatare e matures < 6)

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** burimet e financimit, shpenzimet, kostoja për student, kontrolli financiar, kapacitetet menaxhuese.

Kolegji profesional i Tiranës është një institucion privat që menaxhimin financiar ja ka besuar Asamblesë së ortakëve (Statuti neni 2, pika 5)

Si një institucion i ri, mendojmë që synimi ka qenë investimi në drejtim të infrastrukturës së përshtatshme për programet e studimit, por edhe qëndrueshmëria financiare e institucionit.

Projekt buxheti planifikohet cdo vit, i ndarë në departamentet përkatëse, bazuar nga kërkesat për përballimin e shpenzimeve, por edhe për zgjerimin e kapaciteteve.

### Tregues të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në vitet e fundit** (Tabela 5, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 5

Të ardhurat (në lekë) nga:	Viti 2015	Viti 2016
Tarifat (regjistrim/shkollim/etj)	23%	100%
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)	77%	
SHUMA	100%	100%

Nga Tabela del se institucioni është bazuar në tarifatat dhe burimet e brëndshme të bordit. Në RVB deklarohet se burimet financiare për 5 vitet e ardhshme do të jenë:

- Financimi nga ortakët
- Tarifa e shkollimit të studentëve
- Të ardhura nga shërbimet që ofrohen për të tretë
- Donacione
- Projekte, burime të tjera

- Shpenzimet për vitet e zhvillimit të programit sipas burimit të financimit**

Në RVB institucioni deklaroi koston për student që është 195,680 lekë/në vit. Sipas këtij raporti qëndrueshmëria financiare garantohet nga numri i studentëve që ka patur rritje të dukshme në vitin e dytë. Kështu në programin e studimit Teknologji Automjetesh rritja është gati 3 herë.

Institucioni bën cdo vit pasqyrat financiare me të cilat deklarohet në Zyrën e tatimeve.

### Konkluzionet e GVJ:

Institucioni ka arritur që brënda dy viteve të arrijë qëndrueshmëri financiare dhe zgjerimin e kapaciteteve. Në vitet e ardhshme synohet rritje e buxhetit nga rritja e numrit të studentëve, por edhe nga rrugë të tjera si marrja e të ardhurave nga shërbimet që ofrohen për të tretë, donacione apo projekte, etj.



## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, në funksion të programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Funksionimi i Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC), i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Në zbatim të kërkesës ligjore për sistemin e sigurimit të brëndshëm të cilësisë, është ngritur Njësia e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë (NJSBC). Është një strukturë që përbëhet nga pedagogë, pjesë të stafit ndihmës, një ekspert i jashtë dhe një përfaqësues i studentëve. Ka një "Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJBSC".

Tabela 6

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Antoneta Deda	Kryetar	Dhjetor 2016
2	Ervin Suli	Anëtar	Dhjetor 2016
3	Teuta Halilaj	Anëtar	Dhjetor 2016
4	Jola Osmenaj	Anëtar	Dhjetor 2016
5	Samuel Curraj	Student	Dhjetor 2016
6	Odetta Cati	Ekspert i jashtëm	Dhjetor 2016

Në Tabelën 6 jepen pjesëtarët e zyrës dhe detyrat që kanë. Aktiviteti i kësaj zyre planifikohet dhe për rezultatet e punës hartohen me raportet, në të cilat shënohen gjetjet përkatëse. Me këto raporte njihen strukturat përkatëse, për të marrë masa përmirësimi. Detyrat e NJBSC:

- Vlerësimi, rishikimi i programeve
- Mbarëvajtja e procesit mësimor (realizimi i orëve mësimore, provimet, vlerësimi i studentëve, vlerësimi i praktikave profesionale etj)
- Zhvillimi i procedurës së vlerësimit të pedagogëve nga studentët dhe i pedagogëve të rinj nga më me eksperiencë
- Monitorimi i sekretarisë mësimore
- Etj

Mendojmë se detyrat e kësaj zyre janë shumë të rëndësishme në mbarëvajtjen e programit të studimit dhe në efikasitetin e tij.

Në dosje janë dhënë dhe Formularë vlerësimi të studentëve për vlerësimin e pedagogëve të lëndëve nga studentët dhe Formular për vlerësimin e pedagogut nga pedagogu.

Mendojmë se formularët e vlerësimit nga studentët përfshijnë të gjithë gamën e problematikave të mësimdhënies/mësimnxënies, ndërsa formulari i vlerësimit të pedagogut nga kolegu gjithashtu bën një analizë të orës mësimore të kryer nga pedagogu nga ana pedagogjike dhe didaktike.

### Tregues të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJBSC si:**
  - Sa anketime kanë bërë me studentët e programit të studimit
  - Sa studentë janë anketuar
  - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
  - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
  - Etj

Nga dokumentacioni i dosjes rezulton se janë bërë anketime për të gjithë pedagogët. Pyetësorët organizohen dy herë në vit, në përfundim të semestrit, për të gjitha lëndët /pedagogët.

Numri i studentëve të cilët kanë plotësuar ato varet nga fakti se në sa klasa jep mësim pedagogu përkatës, psh ka pedagogë me 142 pyetësorë. Për 8 pedagogët e paraqitur në raport rezultojnë se janë bërë 530 pyetësorë, të cilat më pas janë përpunuar nga NJBSC.

**Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel programi studimi**

Sic është shkruar edhe më lart përgjegjësinë e ka NJBSC e cila monitoron dhe menaxhon cilësinë e programit .

**Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre**

Rezultatet e vlerësimeve nga studentët janë paraqitur në formën e një table dhe rezultate përmbledhëse. Pyetësorët janë hartuar me pyetje të mbyllura , por edhe me një pyetje të hapur. Rezultatet janë përpunuar nga NJBSC. Në përgjithësi rezultojnë mendime shumë pozitive për stafin akademik.

**Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike**

Politikë e vlerësimit është vlerësimi i performancës së stafit nga eprori, dhe nga NJBSC nëpërmjet pyetësorit të studentit, për:

- Zhvillimin e orës së mësimit nga pedagogu
- Etikën e komunikimit
- Menaxhimi i kohës
- Qartësia e shpjegimit

**Rezultatet e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme**

Rezultatet i bëhen të ditur personelit akademik, për të përmirësuar punën e tyre ose motivuar për më tej ai.

Në dosje janë dhënë edhe vlerësime të drejtuesve (përgj të departamentit) për stafin më të ri. Kjo realizohet duke marrë pjesë në orët e mësimit. Kjo metodë mendojmë se ka shumë efikasitet për të përmirësuar fazat e mësimdhënies.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL , gjatë vizitës**

- a) Formular për vlerësimin e pedagogut, Teknologji Automjetesh, Kolegji Profesional i Tiranës
- b) Formular vlerësimi i studentëve për pedagogun dhe lëndën, Teknologji Automjetesh, Kolegji Profesional i Tiranës
- c) Vendim i Këshillit të Etikës, Teknologji Automjetesh, Kolegji Profesional i Tiranës

**Konkluzionet e GVJ:**

Në zbatim të kërkesës ligjore për sistemin e sigurimit të brëndshëm të cilësisë, është ngritur Njësia e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë (NJSBC). Është një strukturë që përbëhet nga pedagogë, pjesë të stafit ndihmës, një ekspert i jashtë dhe një përfaqësues i studentëve.

Nga dokumentacioni i dosjes rezulton se janë bërë anketime për të gjithë pedagogët. Pyetësorët organizohen dy herë në vit, në përfundim të semestrit, për të gjitha lëndët /pedagogët.

Pyetësorët janë hartuar me pyetje të mbyllura , por edhe me një pyetje të hapur. Rezultatet janë përpunuar



nga NJBSC. Në përgjithësi rezultojnë mendime shume pozitive për stafin akademik.

Në dosje janë dhënë edhe vlerësime të drejtuesve (përgj të departamentit) për stafin më të ri. Kjo realizohet duke marrë pjesë në orët e mësimi. Kjo metodë mendojmë se ka shumë efikasitet për të përmirësuar fazat e mësimdhënies.

## 7. Programi i studimit, organizimi i tij

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Kolegji profesional i Tiranës ka hapur për herë të parë programin e studimit profesional dy vjeçar në Teknologji Automjetesh në vitin akademik 2015-2016, së bashku me disa programe të tjera studimi. Planin mësimor është vlerësuar me një procedurë ligjore nga Këshilli i akreditimit, i cili me Vendimin e tij VKA Nr. 65, datë 30.06.2015 ka dhënë vlerësim *pozitiv*.

Planin mësimor është organizuar në lëndë të formimit bazë, lëndë të formimit karakterizues, lëndë integruese, lëndë me zgjedhje dhe lëndë formuese si anglisht, informatikë, apo praktikë profesionale. Gjithashtu në fund të studimeve studentët i nënshtrohen provimit përfundimtar /ose mbrojnë një temë diplome.

Rishikimi i këtij plani mësimor nga institucioni (shih Tabelën 8) dhe sjellja e tij në Planin që është paraqitur në Tabelën 7, mendojmë se ka përmirësuar variantin e parë, sepse:

- Janë përshtatur më mirë emërtimet e lëndëve
- Është rritur praktika profesionale
- Janë zëvendësuar lëndët, duke ju përshtatur më mirë qëllimit dhe objektivave të programit

### Tregues të matshëm:

#### Organizimi i programit të studimit (në vite/semestra/javë)

- Viti akademik është organizuar në 30 javë, i ndarë në 2 semestar me nga 15 javë
- 1 vit ka mesatarisht 60 kredite (59 dhe 61 kredite)
- 1 kredit ka 25 orë punë të studentit
- 1 orë mësimore ka 60'

Planin mësimor është organizuar në kredite (ECTS) duke mundësuar transferimin e krediteve për studentët.

Nga analiza e krediteve përbërese për cdo lëndë rezulton se raporti midis formave të mësimdhënies është **60 kredite** për leksione/**37 kredite** për ushtrime/**16 kredite** për laboratore/**7 kredite** për praktikë profesionale. Pra raporti teori : praktikë është është **50:50**.

#### Emërtimi i Diplomës:

Diplomë profesionale dy vjecare në Teknologji Automjetesh

#### Planin mësimor

Planin mësimor për programin e studimit jepet në Tabelën 7 (sipas plani mësimor që IAL ka paraqitur në RVB).

Tabela 7

Viti I Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore												Punë e Pavarur	Gjithsej	Provine	
				Leksione			Ushtrime			Laborator/ praktika			Praktikë profesionale						
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur				
1	Matematikë	I	6	4.5	3	21	54	3	36	39						57	93	150	2
2	Fizikë e përgjithshme	I	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
3	Vizatim Teknik ACAD	I	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
4	Bazat teorike të qarqeve elektronike	I	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
5	Bazat e informatikës	I	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
6	Bazat e mekanikës së aplikuar/ Elemente makinash	II	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
7	Anglisht	II	5	3.5	3	21	54	2	24	26						45	80	125	2
8	Sistemet e mjeteve lëvizëse	II	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
9	Sistemi elektrik i mjeteve/ Programim	II	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
10	Bazat e mekanikës strukturale	II	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
	<b>Totali për vitin e parë</b>		<b>59</b>	<b>24.5/23.5</b>	<b>30</b>	<b>210</b>	<b>540</b>	<b>21</b>	<b>252</b>	<b>273</b>	<b>8</b>	<b>168</b>	<b>32</b>			<b>630</b>	<b>845</b>	<b>1475</b>	<b>12</b>









- Kuadri i përgjithshëm formues i Programit të studimit** (Tabela 9, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 9

Tipi i Veprimtarisë (A-F)	Lënda/Moduli	Kreditet	Totali
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A)	Matematikë	6	18
	Fizikë e përgjithshme	6	
	Vizatim Teknik ACAD	6	
Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B)	Bazat teorike të qarqeve elektronike	6	54
	Motorat termikë	6	
	Termoteknikë e aplikuar	6	
	Mekanika e mjeteve lëvizëse	6	
	Sisteme të lëndëve djegëse	6	
	Transmesione të fuqisë	6	
	Sistemet e mjeteve lëvizëse	6	
	Sisteme e diagnostikime elektronike	6	
	Materiale inxhinierike/ Metrologji	6	
Veprimtari në disiplina të Ngjashme dhe/ose integrale (C)	Bazat e mekanikës së aplikuar/ Elemente makinash	6	18
	Bazat e mekanikës strukturale	6	
	Bazat e mekanikës së fluideve	6	
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D)	Programim	6	6
	Sistemi elektrik i mjeteve	6	
Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E)	Bazat e informatikës	6	18
	Anglisht	5	
	Praktikë profesionale	7	
Provimi përfundimtar (F)	Tema diplomimi/ Provimi diplomimi	6	6
			120

- Vlerësimi i Syllabus-eve nga ana cilësore.**

Syllabuset janë hartuar për cdo lëndë dhe përbëhet nga këto elementë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit (ndarja A-F)
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës (nëse ka)
- Objektivat e lëndës, çfarë njohurish dhe aftësish synon të japë kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Mendojmë se syllabuset janë hartuar me të gjithë elementët e duhur. Në RVB dhe gjatë takimeve u deklarua se syllabuset janë produkt i konsultimeve të vazhdueshme me pedagogët e fushës, me programe të ngjashme në Europë dhe pjesë e këshillimeve me Shoqërinë Polytech që ka ekskluzivitetin e laboratorëve.

Studentët njihen me Syllabuset e lëndëve në fillim të semestrit me email, si dhe me platformat online 'Sharefolder' dhe 'Classter'

Nga shqyrtimi i tyre vihet re ndonjë mangësi në emërtimin e temave të laboratoreve. Kemi mendimin se është plotësisht e mundshme, që të plotësohen ato nga titullari i lëndës, në përputhje me përmirësimin e syllabuseve, (sic u diskutua në takimin me stafin akademik, gjatë vizitës në KPT)

- Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës** (Tabela 10, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 10

Lënda /Moduli	Pedagogu/Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti ku është me kohë të plotë	Ngarkesa mësimore (orë)	Statusi PAE apo PAK	
1	Matematikë	Shpëtim Bozo Ervin Suli	Prof.Dr Msc	Teknologji Informacioni	57	PAE PAE
2	Fizikë e përgjithshme	Antoneta Deda Teuta Halilaj Elfrida Topçiu Idajet Selmani	Prof.Dr Msc Dr Msc	Elektro Mekanikë dhe sisteme të Aplikuara	66	PAE PAE PAK PAK
3	Vizatim Teknik ACAD	Miranda Kullolli	Prof As	Elektro Mekanikë dhe sisteme të Aplikuara	66	PAK
4	Bazat teorike të qarqeve elektronike	Piro Cipo Dritan Karriqi Thimi Oço Besnik Sadaj Engjell Ciraku	Prof.Dr Msc Msc Msc Msc	Teknologji Informacioni	66	PAE PAE PAE PAE PAE
5	Bazat e informatikës	Leon Merja	Msc	Teknologji Informacioni	66	PAE
6	Bazat e mekanikës së aplikuar/ Elemente makinash	Marenglen Gjonaj Fejzo Nikollari	Prof.Dr Msc	Elektro Mekanikë dhe sisteme të Aplikuara	66	PAE PAK
7	Anglisht	Petro Plasa	MND	Teknologji Informacioni	45	PAE
8	Sistemet e mjeteve lëvizëse	Ilir Palushaj Gësim Minga	Msc Msc	Elektro Mekanikë dhe sisteme të Aplikuara	66	PAE PAE
9	Sistemi elektrik i mjeteve/ Programim	Konti Tafa	Msc	Elektro Mekanikë dhe sisteme të Aplikuara	66	PAE
10	Bazat e mekanikës strukturale	Arben Dushi Migena Zeqo	Prof.As Msc	Elektro Mekanikë dhe sisteme të Aplikuara	66	PAE PAK
11	Mekanika e mjeteve lëvizëse	Konti Tafa Marjeta Dhima	Msc Msc	Elektro Mekanikë dhe sisteme të Aplikuara	66	PAE PAE
12	Bazat e mekanikës së fluideve	Marjeta Dhima Artur Ruzi	Msc Msc	Elektro Mekanikë dhe sisteme të Aplikuara	66	PAE PAE
13	Motorat termikë	Ilir Palushaj	Msc	Elektro Mekanikë dhe sisteme të Aplikuara	66	PAE
14	Materiale inxhinierike/ Metrologji	Piro Dhimetri	Msc	Elektro Mekanikë dhe sisteme të Aplikuara	66	PAE
15	Transmesione të fuqisë	Konti Tafa	Msc	Elektro Mekanikë dhe sisteme të Aplikuara	66	PAE
16	Sisteme e diagnostikime elektronike	Konti Tafa	Msc	Elektro Mekanikë dhe sisteme të Aplikuara	66	PAE
17	Sisteme të lëndëve djegëse	Ilir Palushaj Elvis Hidërsha	Msc Msc	Elektro Mekanikë dhe sisteme të Aplikuara	66	PAE PAK



18	Termoteknikë e aplikuar	Piro Dhimitri	Msc	Elektro Mekanikë dhe sisteme të Aplikuara	66	PAE
----	-------------------------	---------------	-----	---	----	-----

Nga Tabela rezultojnë se: 1 pedagog angazhohet në 4 lëndë, 1 pedagog angazhohet në 3 lëndë, 2 pedagogë angazhohen në 2 lëndë, 21 pedagogë angazhohen në 1 lëndë.

Departamenti ka ngritur edhe strukturat e stafit pedagogjik, përgjegjës për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor (tutoratin), që ndjek procesin mësimor dhe bën lidhjen midis studentëve dhe stafit akademik, për problematika të ndryshme të procesit mësimor. Cdo grup ka një profesor tutor.

### Vlerësimi sipas standardeve:

<b>Standardi 6: Struktura e programit, rezultatet e të mësuarit dhe proceset e vlerësimit të mësimdhënies janë në përputhje me standardet evropiane.</b>
<p>Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:</p> <p><b>Kriteri 1</b> Programi është në përputhje me Bolonjën, Përshkruesit e Dublinit dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët janë të pajisur me Suplementin e Diplomës që përputhet me rregulloret e BE-së për diplomim</p> <p><b>Kriteri 3</b> Arritjet në nivelin 4 në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, lejojnë regjistrimin në këtë program studimi</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentëve të regjistruar me formim dhe njohuri të ndryshme nga prurjet e zakonshme (jo tradicionale) u ofrohet mbështetje e duhur që në fazat e hershme të programit.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programit ka 120 ECTS dhe lejon transferimin në vitin e 3, të një programi bachelor.</p> <p><b>Kriteri 6</b> Ka një raport të balancuar 50:50 praktikë / teori në programin mësimor, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin e studentëve.</p> <p><b>Kriteri 7</b> Rreth 25% e programit është i vendosur në punë konkrete (p.sh. në një semestër ose i vendosur në pushimet e verës) ose në shkëmbime ndërkombëtare (p.sh. Erasmus+).</p> <p><b>Kriteri 8</b> Mësimi praktik dhe elementëve të punës konkrete u është dhënë pesha e duhur në vlerësim dhe rivlerësim.</p>
<p><b><u>Vlerësimi sipas standardit 6:</u></b></p> <p>Struktura e programit profesional dyvjeçar në Teknologji Automjetesh, është në përputhje me standardet evropiane, sepse programi është në përputhje me Bolonjën, Përshkruesit e Dublinit dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve. PS-TA është hartuar me 120 ECTS dhe studentët mund të kryejnë transferimin e studimeve në vitin e III, të një programi bachelor, sepse kanë të përcaktuara qartë syllabuset lëndore, objektivat lëndore, kreditet, orët në auditor.</p> <p>Struktura e programit në kredite ka një raport 50:50 teori / praktikë. Mësimi praktik në laboratore dhe ofcinat e shkollës dhe puna praktike konkrete (në ofcinat dhe ndërrmarjet e ndryshme me të cilat shkolla ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi) u është dhënë pesha e duhur. Kjo gjithashtu realizohet edhe në vlerësimin e studentëve me notë. Rreth 11.2 % e orëve mësimore të programit përmban praktikë profesionale, që zhvillohet në semestrin e IV. Mungojnë shkëmbimet në kuadër të Erasmus+.</p> <p>Bazuar në ligjin e arësimit të lartë një student kalon nga një vit akademik në një vit tjetër akademik kur ka shlyer 50% të programit mësimor pra ka marë 30 kredite.</p> <p>Regjistrimi i studentëve, metodat e mësimdhënies, rezultatet e të mësuarit dhe proceset e vlerësimit të mësimdhënies janë në përputhje me standardet evropiane, sepse studentët me arritjet në nivelin 4 në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe që zotërojnë një diplomë të shkollës së mesme, lejohen të regjistrohen në këtë program studimi. Gjithashtu për t'u regjistruar studenti mund të ketë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diplomë të sistemit të vjetër (4 vite)</li> </ul>

- Diplomë të shkollës së mesme profesionale (5 vite)
- Diplomë tjetër të shkollës së mesme, të ndjekur në një institucion jashtë vëndit dhe që njihet si e vlefshme në përputhje me legjislacionin në fuqi
- Diplomë tjetër universitare të marrë brënda apo jashtë vëndit dhe kërkon të ndjekë një program të dytë studimi
- Dëshirë të transferojnë studimet nga IAL të tjera universitare ose jouniversitare për të riorientuar studimet e tyre. Në këtë rast procedura e njohjes së krediteve bëhet në departamenti.

Studentëve të regjistruar me formim dhe njohuri të ndryshme nga prurjet e zakonshme (jo tradicionalë) u ofrohet mbështetje për programin.

Institucioni ka përgatitur Supplementin e Diplomës që përputhet me rregulloret e MAS dhe që do të shoqërojë diplomën.

#### **Konkluzionet e GVJ:**

Struktura e programit, rezultatet e të mësuarit dhe proceset e vlerësimit të mësimdhënies janë në përputhje me standardet evropiane dhe këkesat ligjore të Arsimit të lartë në Shqipëri.

Plani mësimor është organizuar në lëndë të formimit bazë, lëndë të formimit karakterizues, lëndë integruese, lëndë me zgjedhje dhe lëndë formuese si anglisht, informatikë, apo praktikë profesionale. Gjithashtu në fund të studimeve studentët i nënshtrohen provimit përfundimtar /ose mbrojnë një temë diplome.

Plani mësimor është organizuar në kredite (ECTS). Struktura e programit në kredite ka një raport 50:50 teori / praktikë.

Rishikimi i planit mësimor nga institucioni (ndryshimi i planit mësimor rezulton në 20 kredite që përbëjnë 16.6%) mendojmë se ka përmirësuar variantin e parë, sepse:

- Janë përshtatur më mirë emërtimet e lëndëve
- Është rritur praktika profesionale
- Janë zëvendësuar apo bashkuar lëndë, duke ju përshtatur më mirë qëllimit dhe objektivave të programit

Regjistrimi i studentëve, metodat e mësimdhënies, rezultatet e të mësuarit dhe proceset e vlerësimit të mësimdhënies janë në përputhje me standardet evropiane, sepse studentët me arritjet në nivelin 4 në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe që zotërojnë një diplomë të shkollës së mesme, lejohen të regjistrohen në këtë program studimi.

Institucioni shoqëron Diplomën me Supplementin e Diplomës që përputhet me rregulloret e MAS.

*Rekomandim:* Mendojmë se 3.6 % e krediteve mund të ndryshojnë në drejtim të rritjes së praktikave profesionale duke i shtrirë atë edhe në vitin parë.



## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Organizimi i mësimdhënies në Programin e studimit profesional dy vjeçar në Teknologji Automjetesh përdoren format e studimit si më poshtë (ref. RVB dhe Planit mësimor):

**Leksione:** Për leksionet është përcaktuar 1 kredit = 7 orë mësimore në auditor dhe 18 orë mësimore punë e pavarur e studentëve. Të gjitha lëndët formuese kanë 3 kredite për leksionet. Në Rregulloren e programit të studimit është ëprcaktuar se ndjekja e leksioneve është e detyrueshme në masën 60% nga studentët. Në vizitë dhe takimet e zhvilluara u theksua se studentët e kanë përqindjen e ndjekjes së leksioneve më të lartë se 60%, sepse pedagogët synojnë të jenë më të kujdesshëm dhe më atraktivë në punën e tyre.

**Ushtrime:** Ushtrimet janë pjesë e mësimdhënies që synojnë përforcimin e dijeve të marrë në leksione dhe zbatimin praktik të tyre në shëmbuj teknologjikë. Për ushtrimet është përcaktuar 1 kredit = 12 orë mësimore në auditor dhe 13 orë mësimore punë e pavarur e studentëve. Të gjitha lëndët formuese kanë 2 kredite për ushtrime. Në Rregulloren e programit të studimit është përcaktuar se ndjekja e ushtrimeve është e detyrueshme në masën 60% nga studentët.

**Labororet/Praktika profesionale:** Janë pjesë e mësimdhënies që synojnë zbatimin në praktikë të dijeve të marrë në leksione dhe dhe përfitimin e shikahësive dhe shprehive shumë të domosdoshme në profesionin që do marrin studentët. Për Labororet/Praktikën profesionale është përcaktuar 1 kredit = 21 orë mësimore në auditor dhe 4 orë mësimore punë e pavarur. Të gjitha lëndët kanë 1 kredit për Labororet. Ndërsa për praktikën profesionale janë përcaktuar 7 kredite. Në Rregulloren e programit të studimit është përcaktuar se ndjekja e ushtrimeve është e detyrueshme në masën 80% nga studentët.

**Rekomandim:** Grupi rekomandon se detyrimet e studentëve për labororet dhe praktikën profesionale të jenë 100%, për shkak të rëndësisë që ato kanë në formimin e studentëve, me aftësi dhe kompetenca profesionale. Te parashikohen ne sylabuset e lendeve, numuri i studenteve per grupe laborator, pasi rritja ndjeshem e numurit te studenteve per program studimi, ne vitet e ardheshme, do te sillte nje veshtiresi ne organizimin e realizimit te laboratoreve, praktikave.

### Tregues të matshëm:

- Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies në programin e studimit,** (Tabela 11, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 11

Programi i Studimit jouniversitar 2 vjeçar në Teknologji Automjetesh	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	393
Seminare /Ushtrime	444
Laboratore	336
Praktikë profesionale	147
Në total	<b>1320</b>

Nga analiza e orëve mësimore rezulton se në përqindje, raporti ndërmjet tyre është: **29.8 %/ 33.6 %/ 25.4 % / 11.2 %**. Pra rreth 70% janë orë në praktikë.

- Format e kontrollit të njohurive** (Tabela 12, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 12

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	10 %
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale, etj)	30 %
Provimi përfundimtar	60 %
Në total	100%

Kjo ndarje ka funksionuar dhe është ndjekur nga të gjithë pedagogët. Për këtë u vëzhguan procesverbalet në sekretarinë e shkollës.

- Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë jashtë procesit mësimor** (Tabela 13, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 13

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Projekte/praktika në rang Institucioni	0
Punime individuale të pedagogëve	0
Projekte /praktika në rang Departamenti	0
Projekte në bashkëpunim me të tjerë	0

Mendojmë se Tabela tregon faktin se institucioni është akoma i ri dhe përfshirja e studentëve në organizimin e aktiviteteve shkencore/profesionale në këtë institucion është akoma inekzistent. Duhet theksuar se statusi i Kolegjit në hierarkinë e IAL nuk e përfshin kërkimin shkencor si detyrim statutor.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Në RVB dhe në takimet që u zhvilluan gjatë vizitës theksohet politika institucionale në të cilën sundon filozofia “studenti në qendër”. Kjo përkthehet në:

- Detyra dhe të drejta të qarta të studentëve të përcaktuara në dokumentacionin bazë të KPT
- Studentët marrin pjesë në të gjitha organet drejtuese të KPT, si në senat, dekanat, grupet e vlerësimit të brendshëm, në vlerësimin e stafit akademik etj.
- Ato kanë organizimin e tyre (Këshillin studentor) që shërben për të transmetuar problemet e studentëve në këto organe
- Studentët marrin të gjithë informacionin e nevojshëm për programin e studimit, syllabuset si dhe për aktivitete të ndryshme të procesit mësimor.



Studentët e regjistruar në KPT nënshkruajnë një kontratë që shërben për rregullimin e marrëdhënieve ligjore midis palëve.

Cdo student ka dosjen e tij që e shoqëron dhe përmban:

- Formularin e aplikimit për regjistrim
- Dëftesën e shkollës së mesme
- Kontratën e studentit
- 2 fotografi
- Fotokopje e Kartës së identitetit

Grupi i VJ vëzhgoi disa dosje studentësh.

#### **Procedurat e pranimit të studentëve**

Sistemi ligjor i regjistrimit të studentëve për shkollat private ka ndryshuar në dy vjet të jetës së Kolegjit Profesional të Tiranës. Në vitin 2015 regjistrimi në institucionet private ka qenë i lirë dhe studentët janë paraqitur individualisht për regjistrim. Ndërsa në vitin 2016 në sistemin e aplikimit online në Sistemin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve u futën edhe Institucionet private, gjë që solli një menaxhim të listës së fituesve nga vetë Portali i AKP. Ishin studentët që zgjidhnin të regjistroheshin në programet që kishin dalë fitues. Gjithashtu në këtë vit u zbatua ligji i arsimit të lartë për mesataren e pranimit në Universitet mbi 6.

#### **Kushte specifike të pranimit të studentëve**

Kolegji Profesional i Tiranës nuk ka kushte specifike të regjistrimit të studentëve, përveç kërkesave ligjore të regjistrimit, që i nënshtrohen të gjithë studentët, në bazë të udhëzimeve të MAS.

#### **Tregues të matshëm:**

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve** (Tabela 14, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 14

Programi i studimit 2 vjeçar profesional në Teknologji Automjetesh	Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)	Nota Mesatare	Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)	Nota Mesatare
2015-2016	22	6.04	akoma	N/A
2016-2017	62	6.11	akoma	N/A
Në total	84	6.07		

Nga të dhënat e RVB dhe sekretarisë aktualisht ndjekin studimet 81 studentë, sepse janë c'regjistruar 3 studentë të brezit 2015-2017.

Target i shkollave profesionale janë nxënësit me notë mesatare të ulët, prandaj mendojmë se cilësia e studentëve në hyrje është normale.

#### **Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend**

Organizimi i këtij programi, bazuar në Procesin e Bolonjës e lejon mobilitetin nga dhe drejt KPT.

## Vlerësimi sipas standardeve:

### **Standardi 3: Qasja e studentëve në mësimdhënie është mbështetur përmes hartimit të programit**

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

- Kriteri 1** Hartimi i Programit të studimit është mjaftueshëm fleksibël për të mundësuar që studimi të përshtatet me punësimin.
- Kriteri 2** Përvojat e studentëve të fituara nga puna e tyre e mëparshme, janë integruar në modulet dhe vlerësimin e studentëve.
- Kriteri 3** Përmbajtja e Programit është aktuale dhe i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe/ose kërkesat për aftësitë/shprehjet nga punëdhënësit.
- Kriteri 4** Vlerësimi dhe feedback-u i studentëve është përdorur në mënyrë efektive, për të mbështetur studentët jo tradicionale dhe të mësuarit e nxënësve me performancë të ulët
- Kriteri 5** Mësimdhënia përfshin metoda të ndryshme pedagogjike që i përshtaten studentëve të ndryshëm, p.sh. të mësuarit në veprim, puna në ekip dhe të mësuarit në formë të pavarur.

#### **Vlerësimi sipas standardit 3:**

Mendojmë se KPT që në krijimin e tij dhe në hartimin e Programit të studimit dy vjeçar Teknologji Automjetesh ka menduar në rradhë të parë për tju përgjigjur kërkesave të tregut të punës për profesionistë të formuar plotësisht, prandaj edhe synimi përfundimtar është përshtatja me punësimin. Fakti që programi është rishikuar dhe janë bërë disa ndryshime të nevojshme për tju përshtatur me teknologjitë e reja e tregon këtë.

Përmbajtja e Programit të studimit mendojmë se plotëson kërkesat e profesionit dhe gjatë zhvillimit të tij synon të formojë aftësitë dhe shprehjet sipas kërkesave të punëdhënësve. Fakti i zhvillimit të praktikës profesionale pranë punëdhënësve të mundshëm, krijon lidhje të dyanëshme.

Gjatë vizitës grupi u njoh me punën e stafit akademik për të ndihmuar studentët, sidomos ato më të dobët në përparim. Kjo arrihet duke i ofruar të gjithë studentëve leksionet në formë dixhitale, duke krijuar grupe të vogla laboratorësh, duke zhvilluar orë shtesë me studentët që kanë vështirësi ose që kanë pasion për të mësuar më shumë në lëndë të caktuara. Kështu mësimdhënia përfshin metoda të ndryshme pedagogjike që i përshtaten studentëve me aftësi të ndryshme.

### **Standardi 4: Rezultatet e të mësuarit komunikohen që nga pranimi i studentëve deri në diplomim dhe janë shqyrtuar dhe vlerësuar**

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

- Kriteri 1** Informacioni për mundësitë e regjistrimeve është i qartë dhe i publikuar, si dhe i mbështetur me udhëzime ndihmuese të stafit.
- Kriteri 2** Ekziston një praktikë efektive e punës në ekip, midis stafit të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe stafit të IAL.
- Kriteri 3** Synimet e programit dhe rezultatet e të mësuarit për elementët praktikë dhe akademikë janë të qarta, të mbështetura nga publikimi i rezultateve të të mësuarit në nivel moduli
- Kriteri 4** Monitorimi i bibliotekës dhe i burimeve të tjera të mësimdhënies dhe të të nxënësve është bërë rregullisht. Janë ndërmarrë rregullisht praktika specifike të punësimit dhe zhvillimi i aftësive.

#### **Vlerësimi sipas standardit**

Në RVB por edhe në takimet me drejtuesit theksohet se KPT bën një punë paraprake për informimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve të shkollave të mesme për mundësitë e regjistrimit në këtë institucion, përfitimet që kanë sidomos në drejtim të punësimit. Për këtë realizohen:

- Takime informimi nëpër shkollat e mesme ose në ambientet e KPT,
- Përgatitje dhe shpërndarje e broshurave apo fletëpalosjeve informuese apo promocione në media dhe ëbsite. Pjesëmarrja në rrjetet sociale



- Puna e zyrës informuese e cila orienton dhe informon të interesuarit;
- Pjesëmarrje në panairët e tregut të punës

Pedagogët dhe punonjësit që ndjekin praktikën profesionale ose laboratorët punojnë së bashku me pedagogët e teorisë dhe bëjnë vlerësim të përbashkët të studentit (nota e studentit është një shumatore e të gjithë veprimtarive mësimore të studentit).

Puna me bibliotekën është në fillimet e saj.

#### **Konkluzionet e GVJ:**

Politika institucionale në KPT është “studenti në qendër”

Cdo student ka dosjen e tij. Studentët e regjistruar në KPT nënshkruajnë një kontratë që shërben për rregullimin e marrëdhënieve ligjore midis palëve.

Procedurat e pranimit të studentëve në të dy vitet janë zhvilluar sipas rregullores së Ministrisë. Kolegji Profesional i Tiranës nuk ka kushte specifike të regjistrimit të studentëve. Nga të dhënat e RVB dhe sekretarisë aktualisht ndjekin studimet 81 studentë, sepse janë regjistruar 3 studentë të brezit 2015-2017. Target i shkollave profesionale janë nxënësit me notë mesatare të ulët, prandaj mendojmë se cilësia e studentëve në hyrje është normale.

Përmbajtja e Programit të studimit mendojmë se plotëson kërkesat e profesionit dhe gjatë zhvillimit të tij synon të formojë aftësitë dhe shprehitë sipas kërkesave të punëdhënësve. Fakti i zhvillimit të praktikës profesionale pranë punëdhënësve të mundshëm, krijon lidhje të dyanëshme.

KPT bën një punë paraprake për informimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve të shkollave të mesme për mundësitë e regjistrimit në këtë institucion, në programet e tij dy vjecare. Rritja e numrit të studentëve të regjistruar e tregon këtë. Mësimdhënia përfshin metoda të ndryshme pedagogjike që i përshtaten studentëve me aftësi të ndryshme.

Pedagogët dhe punonjësit që ndjekin praktikën profesionale ose laboratorët punojnë së bashku me pedagogët e teorisë dhe bëjnë vlerësim të përbashkët të studentit (nota e studentit është një shumatore e të gjithë veprimtarive mësimore të studentit).

Puna me bibliotekën është në fillimet e saj.

*Rekomandim:* Të shihet mundësia për të nxjerrje në dukje vlerat e punëve të pavarura të studentëve, nëpërmjet referimeve më të gjera, ose nëpërmjet teknologjisë pamore, digjitale, pasi është një mënyrë shumë e mirë, për nxitjen e iniciativës individuale tek studentët. Gjatë vizitës në institucion, në kontaktin me studentët, rezultoi që ekzistonte ky element, (ka studente që realizonin punime në laboratorët e KPT, jashtë programit të studimit), por duhet një organizim në përputhje me qëllimin strategjik të KPT.

## **10. Aktivitetet profesionale në funksion të programit të studimit**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** aktivitetet e organizuara nga njësi, lidhja e njohurive me praktikën profesionale, vlerësime zyrtare të aktivitetit individual të studentëve ose në njësinë.

Në Raportin e vlerësimit të brendshëm, janë dhënë informacione të shumta për aktivitetet që organizohen në kuadër të:

- Krijimit të një ambienti bashkëpunues të stafit me studentët;
- Krijimit të të klubeve studentore, si psh Klubi i Inovacionit, që shërben të nxisë projekte dhe aktivitete innovative
- Pjesëmarrjes në aktivitete që organizojnë palët bashkëpunuese. Për programin Teknologji Automjetesh është organizuar aktivitet trainues me studentët nga Ministria e Mjedisit dhe UNEP(United Nations Environment programme) me temë: Mbrojtja e shtresës së ozonit. Studentët janë pajisur edhe me certifikatë;
- Pjesëmarrjes së studentëve në panairët e punës
- Trainimit të vazhdueshëm të stafit akademik në kuadër të kualifikimit të vazhdueshëm

#### **Konkluzionet e GVJ:**

Në bazë të statusit Kolegj profesional, institucioni ka gjetur rrugë dhe mjete për të realizuar aktivitete profesionale për të ndihmuar në krijimin e një ambienti të shëndetshëm dhe në funksion të përmbushjes së misionit të saj

## **11. Bashkëpunimi kombëtar (dhe ndërkombëtar)**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** Bashkëpunimet e realizuara nga njësia kryesore me tregun e punës që lidhet me këtë program studimi, si në nivel rajonal ashtu edhe në nivel kombëtar/ ndërkombëtar. Përfitimet institucionale, në nivel program apo në nivel studentësh gjatë këtyre bashkëpunimeve.

Në kuadër të realizimit të praktikave profesionale të studentëve KPT ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi në nivel Kombëtar (në periudhën 2016 -2017), për një afat të pacaktuar, me subjektet si më poshtë:

- Rapid Repair
- Hyundai Auto Albania shpk
- Servia Auto Shpk
- Besland Shpk
- Samina Auto Shpk
- Artinel 95 shpk

Në RVB dhe në takimet e zhvilluara me drejtuesit është theksuar se në Strategjinë Institucionale të Zhvillimit 2015-2020 janë përcaktuar edhe synime për partneritet dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

### **Tregues të matshëm:**

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar (dhe ndërkombëtar)** (Tabela 16, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 16



Aktivitete individuale ose në rang Institucioni, në kuadër të bashkëpunimit kombëtar në vitet e fundit		
1	Orë mësimore (leksione/seminare dhe praktika) të realizuar nga lektorë të huaj:	-
2	Orë mësimore (leksione/seminare dhe praktika) të realizuar nga lektorë vendas jashtë vendit	-
3	Numri i trainimeve fushën profesionale jashtë vendit <ul style="list-style-type: none"> <li>- Trainim i stafit për sistemin Cluster nga Verti Tech SA</li> <li>- Trainim për studentët organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe UNEP</li> <li>- Trainim i stafit nga Polytech</li> </ul>	3

**Konkluzionet e GVJ:**

Kolegj profesional, ka nënshkruar disa marrëveshje kombëtare. Në këtë institucion pranohet si një pikë e dobët që duhet përmirësuar në vitet në vijim krijimi i lidhjeve ndërkombëtare, për të realizuar bashkëpunime që synojnë punësimin e studentëve.



## ANALIZA SWOT

Analiza përmbledhëse sipas metodës SWOT (Strengths, Weaknesses-, Opportunities, Threats).

### a. Pika të forta

Institucioni ka vendosur në RVB disa pika të forta me të cilat ne jemi dakort. Ato janë:

- Programi i studimit dy vjeçar profesional në Teknologji automjetesh është hartuar sipas Procesit të Bolonjës dhe është unik në Shqipëri. Ai ofrohet nga një IAL që ka strategji të vetën ofrimin e programeve të tilla, shumë të kërkuara nga tregu i punës.
- Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin e nevojshëm akademik dhe profesional. Drejtuesit janë kujdesur edhe për harmonizimin e brezave të cilët kontribuojnë me eksperiencën dhe pasionin.
- KPT ka politika që synojnë tërheqjen e stafit sa më të kualifikuar dhe brënda profesionit, duke krijuar një ekip që kërkon të japë më të mirën për studentët;
- Infrastruktura dhe laboratorët të cilët janë të përshtatshëm dhe në funksion të zbatimit në praktikë të njohurive teorike, duke ndihmuar në krijimin e aftësive dhe kompetencave profesionale.
- Bashkëpunimi me kompanitë e biznesit, si në zhvillimin e praktikave profesionale, në thithjen e mendimit të tyre për hartimin dhe përmirësimin e kurrikulave, por edhe si një mundësi për punësimin e ardhshëm të studentëve;
- Integrimi i studentëve në tregun e punës gjatë periudhës së studimeve, pa cënuar procesin akademik.

### b. Pika të dobëta (ose pikat ku ka vend për përmirësim)

Institucioni ka vendosur në RVB disa pika të dobëta me të cilat ne jemi dakort. Ato janë:

- Biblioteka e Kolegjit është në hapat e para dhe duhet vazhduar në pasurimin e saj me literaturë sa më bashkëkohore në fushat e teknologjive inxhinierike. Duhet theksuar se në Shqipëri nuk ka traditë në këtë nivel/fushë akademike dhe Kolegji është mbështetur në literaturën inxhinierike të Universitetit, ose në hartimin e leksioneve të përshtatshme për nivelin 5 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve
- Mungesa e marrëveshjeve me partnerë ndërkombëtare, sidomos në projekte të përbashkëta.

Grupi i vlerësimit të jashtëm mendon se janë pika të dobëta dhe duhen përmirësuar edhe:

- Detyrimet e studentëve për frekuentim në laboratorët dhe praktikën profesionale, që aktualisht janë 80%. Mendojmë se frekuentimi i përcaktuar në Rregulloren e programit duhet të jetë 100%, për shkak të rëndësisë që ato kanë në formimin e studentëve, me aftësi dhe kompetenca profesionale.
- Puna në publikimin, reklamimin e strategjisë së KPT, për thithjen e studenteve.

### c. Mundësitë

Institucioni ka vendosur në RVB disa pika të mundësive për përmirësim, me të cilat ne jemi dakort. Ato janë:

- Institucioni ofron dhe do të ofrojë më shumë mundësi për të mbështetur stafin në rritjen profesionale



- Mundësi për të rritur bashkëpunimet me bizneset vëndase, për të siguruar zhvillimin e praktikave profesionale, në sasi dhe cilësi të lartë, aq më tepër që institucioni deklaron se synon një numër deri në 2400 studentë në të gjithë programet e studimit që ofron.
- Mundësi për të rritur bashkëpunimet midis KPT dhe partnerëve ndërkombëtare, sidomos në projekte të përbashkëta, shkëmbime eksperiencash akademike, ose studentësh;
- Mundësi të investimeve të mëtejshme për shtimin e kapaciteteve dhe numrit të oficinave dhe laboratorëve teknologjikë;

Grupi i vlerësimit të jashtëm mendon se Institucioni duhet të shohë mundësitë edhe në drejtim të:

- Akreditimit të laboratorëve dhe futjes së tyre në shërbim për të tretë;
- Angazhim në formën e kontratës për dhënien e shërbimit falas (punë e kryer nga studentët, stafi ndihmës akademik), në riparimin e mjeteve të transportit të institucioneve shtetërore, sociale (OJQ), Qendrat shëndetësore, etj, me buxhet të dobët. Kemi mendimin se kjo gjë arrin të plotësojë deri diku edhe njohuritë e studentit në organizimin e riparimeve me kontratë periodike.
- Mundësi për rritjen e numrit të studentëve, mbështetur edhe nga politikat shtetërore të përkrahjes së arsimit profesional (rritja e mesatares së shkollës së mesme për t'u regjistruar në Universitet). Ky është një oportunitet për rritjen e kapaciteteve të shkollave profesionale.

#### **d. Pengesat**

Institucioni ka vendosur në RVB disa pengesa të funksionimit të tij, me të cilat ne jemi dakort. Ato janë:

- Numri relativisht i vogël i studentëve. Tregu i vogël i arsimit në Shqipëri.
- Konceptet akoma mbizotëruese të të rinjve që kërkojnë të studjojnë në Universitet dhe jo në shkolla profesionale.

Grupi i vlerësimit të jashtëm mendon se ka pengesa edhe në drejtim të:

- Mungesës së akteve nënligjore dhe e udhëzimeve për këtë lloj edukimi, në drejtim të ndihmës ekonomike për studentët, ose në shërbimet për të tretë, etj.
- Kostove të larta të blerjes së laboratorëve dhe pajisjeve didaktike

#### **Rekomandime:**

Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon se detyrimet e studentëve për laboratorët dhe praktikën profesionale të jenë 100%, për shkak të rëndësisë që ato kanë në përgatitjen e studentëve, me aftësi dhe kompetenca profesionale.

Në syllabuset e lendeve duhet të përcaktohet numri i studenteve për grupet e laboratorëve, sepse rritja ndjeshme e numrit të studenteve në vitet e ardhshme, do të sillte veshtiresi në organizimin e tyre.

Mendojmë se rritja e orëve (krediteve) për praktikën profesionale është shumë e vlefshme. Megjithatë mendojmë se ka vënd përsëri për shtimin e krediteve në këtë lëndë. Kjo do t'i aftësojë më shumë studentët në drejtim të shkathtësive dhe shprehive të nevojshme në procese të shumëllojshme që ka kjo fushë shërbimesh.

Të shihet mundësia që laboratorët dhe ofcinat të vihen në shërbim të të tretëve, duke krijuar të ardhura për shkollën, por dhe duke e afruar studentin më shumë në kushtet reale të tregut të punës në ofcinat e shkollës

Të shihet mundësia që në ambjettet e laboratoreve, ofcinave të kete pankarta, informacione pamore, të dedikuara këto sipas tematikave të laboratoreve. Gjithashtu gjatë orëve laboratorike të kete video mbi veprimtrinë praktike, që zhvillohet në keto laboratorë. Këtë rekomandim e japim në perputhje me nivelin e studentit, i cili është me prirje më të madhe drejt informacionit pamor, se sa të shkruar (mesatare e matues më e vogël se 6)

Të shihet mundësia për të nxjerre në dukje vlerat e punëve të pavarura të studenteve, nëpërmjet referimeve me të gjera, ose nëpërmjet teknologjive pamore digjitale, pasi është një mënyrë shumë e mirë, për nxitjen e iniciativës individuale tek studentët. Gjate vizites në institucion, në kontaktin me studentet, rezultoi që ekzistonte ky element (ka studente që realizonin punime në laboratorët e KPT, jashtë programit të studimit), por duhet një organizim në perputhje me qëllimin strategjik të KPT.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

**Dr. Gazment Qatipi**

## **SWOT ANALYSE**

### **Summary Analysis by SWOT (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats)**

#### **a. Strong points**

The institution has set on RVB some strong points with which we agree. They are:

- The two-year professional study program in 'Vehicle Technology' has been developed under the Bologna Process and is unique in Albania. It is provided by a HEI, which has its own strategy to offer such programs, which are very much appreciated by the labor market.
- Academic staff engaged in this study program has the necessary academic and professional qualification. College leaders have also taken care of the harmonization of different staff generations, who contribute with experience and passion.
- The CPT has policies aimed at attracting the most qualified staff and within the profession by creating a team that seeks to provide the best for the students;
- Infrastructure and laboratories are appropriate and in function of the practical application of theoretical knowledge, helping to create professional skills and competences.
- Cooperation with business companies, both in developing professional practices and in absorbing their thinking on curriculum design and improvement, but also as an opportunity for future employment of students;
- Integrating students into the labor market during the study period, without affecting the academic process.



**b. Weak point (or points where there are opportunities for improvement)**

The institution has set on the RVB some weak points, with which we agree. They are:

- The College Library is in the first steps, and should continue in its enrichment, with the most modern literature in the field of engineering technologies. It should be noted that in Albania there is no tradition at this level / academic field, and the College has relied on the University's engineering literature, or in the design of appropriate lessons for level 5 of the National Qualifications Framework;
- Lack of agreements with international partners, especially in joint projects.

But, External Evaluation Group thinks are weak points and should improve the following issues:

- The obligations attendance which set out in the Program Regulation, for the labs and professional practice should be 100%, due to their importance in preparing students with skills and professional competence. Students' obligations to attend the laboratories and professional practice are currently 80%.
- Work on publishing, advertising the CPT's strategy to increase the number of registered students.

**c. Improvement opportunities**

The institution has set in the RVB some points of improvement opportunities with which we agree. They are:

- The institution offers and will provide more opportunities to support staff in professional training;
- Opportunities to increase co-operation with local businesses, to ensure the development of professional practices, in quantity and high quality, more so that the institution declares that it targets up to 2400 students in all the study programs it offers.
- Opportunity to increase co-operation between the CPT and international partners, especially in joint projects, exchange of academic experiences or student exchanges;
- Opportunities for further budget investments to increase capacity and number of Wards Auto Repair and laboratories;

The External Evaluation Group thinks that the Institution should look at opportunities in terms of:

- Accreditation of laboratories and their introduction into the service for third parties;
- Involvement in the form of a contract for free service (work done by students, academic staff), in repairing the vehicle of transport in state institutions, social (non government organizations), health institutions, with a low budget. We think that this complements the student's knowledge in organizing repairs, with a periodic contract.
- Opportunities to increase the number of students, also supported by State policies in support of vocational education. This is an opportunity to increase the capacity of vocational schools.

**d. threats**

The institution has decided on RVB some threats to its functioning, with which we agree. They are:

- The relatively small number of students and the small education market in Albania.

- Concepts, still prevalent in young people, who seek to study at the University and not in vocational schools.

The external Evaluation group thinks there are threats in terms of:

- Lack of sub-legal acts and guidelines for this kind of education, (in terms of economic assistance to students, or third-party services, etc.)
- High cost of purchasing labs and didactic equipment

**Recommendations:**

- The External Evaluation Group recommends that students' obligations to laboratories and professional practice be 100% due to the importance they have in preparing students with skills and professional competence.
- The number of students for the lab groups should be determined in the subject syllabi, because the significant increase in the number of students in the coming years would create difficulties in organizing them.
- We think that there is a need for the addition of number of credits in the subject "Professional Practice". This will enable the students more, in terms of the technical skills needed in the diverse processes that this field of services has.
- Consider the possibility that laboratories and Wards Auto Repair will put in service to third parties to create a financial budget for the school, but also to bring the student closer to the real conditions of the labor market.
- To see the possibility of labels, labs, etc. in the labs, visual information, dedicated according to the themes of the labs. Also during the laboratory hours, have a video about the practical activity that takes place in these labs. We give this recommendation in line with the level of student who is more inclined towards visual information than written (average notes less than 6)
- See the possibility of highlighting the values of independent student work, by reference, or through digital visual technology, as this is a very good way of encouraging student individual initiative. During the site visit, in contact with the students, it turned out that this element exists (there are students performing individual works in CPT laboratories outside the study program), but it needs organization in line with the CPT's strategic goal.